



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

Tiranë, më 27.10.2020  
(Dokument Parlamentar)

**RAPORT**

**PËR DEKRETIN E PRESIDENTIT NR. 11797, DATË 22.10.2020, “PËR KTHIMIN E  
LIGJIT NR. 118/2020 ‘PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10019,  
DATË 29.12.2008, ‘KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË’ I  
NDRYSHUAR**

**- HYRJE**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e datës 27.10.2020 shqyrtoi Dekretin e Presidentit nr. 11797, datë 22.10.2020, “Për kthimin e ligjit nr. 118/2020 ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, ‘Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë’ i ndryshuar.

Në cilësinë e komisionit përgjegjës, komisioni e shqyrtoi Dekretin bazuar në nenin 86 dhe në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Ligji nr. 118/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, u miratua nga Kuvendi në seancën e datës 5 tetor 2020.

Ndryshimet në Kodin Zgjedhor, të miratuara me ligjin nr.118/2020, kanë si qëllim kryesor reflektimin e ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr.115/2020, si dhe harmonizimin e disa dispozitave me ndryshimet e Kodit Zgjedhor, të miratuara me ligjin nr.101/2020.

Bazuar në nenin 85 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Presidenti i Republikës ka depozituar pranë Kuvendit dekretin nr. 11797, datë 22.10.2020, “Për kthimin e ligjit nr. 118/2020 ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, ‘Kodi Zgjedhor i Republikës

së Shqipërisë'. Sipas nenit 26, pika 7, të Rregullores së Kuvendit, ky dekret përfshihet automatikisht në programin e punës së Kuvendit.

## **I. DISKUTIMI I DEKRETIT TË PRESIDENTIT NË KOMISIONIN PËR ÇËSHTJET LIGJORE**

Në mbledhjen e Komisionit për shqyrtimin e Dekretit ishin të pranishëm z. Bledar Dervishaj dhe znj.Katrin Treska, përfaqësues të institucionit të Presidentit të Republikës.

Përfaqësuesit e institucionit të Presidentit, paraqitën në mënyrë të përmbledhur argumentet për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr.118/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar .

Në vazhdim të diskutimit, relatori z.Adnor Shameti dhe anëtarë të Komisionit paraqitën opinionin e tyre lidhur me argumentet e paraqitura nga Presidenti i Republikës në Dekret.

Lidhur me çështjet e ngritura në Dekretin e Presidentit të Republikës, relatori paraqiti argumentet dhe vlerësimet si më poshtë.

### **-ARGUMENTET E PARAQITURA NË DEKRETIN N.11797, DATË 22.10.2020 PËR KTHIMIN NË KUVEND PËR RISHQYRTIM TË LIGJIT NR.118/2020 “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10019, DATË 29.12.2008, “KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, SI DHE VLERËSIMI I TYRE**

Para shqyrtimit të argumenteve të veçanta të paraqitura në Dekret, fillimisht konstatohet dhe vlerësohet se:

- *Argumentet e Presidentit nga pika I deri në pikën XI të Dekretit janë argumente që nuk kanë lidhje me Kodin Zgjedhor, por opinione të Presidentit me karakter më së shumti politik dhe mënyrën si Presidenti e percepton ose dëshiron ta perceptojë situatën politike dhe veprimtarinë e institucioneve në vend.*
- *Për sa i takon Komisionit për Çështjet Ligjore, detyra e tij është të shqyrtojë argumentet e Presidentit vetëm për çështjet që kanë të bëjnë me ndryshimet në Kodin Zgjedhor.*
- *Argumentet, në thelb, i referohen më shumë mosdakordësisë së Presidentit për ndryshimet në Kushtetutë të 30 korrikut 2020, se sa ndryshimeve të Kodit Zgjedhor të miratuar në Kuvend në 5 tetor 2020, me ligjin nr.118/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, ndryshime që reflektojnë ndryshimet kushtetuese të 30 korrikut. Vlen të theksohet se Kushtetuta nuk legjitimon presidentin të argumentojë apo kontestojë ndryshimet e Kushtetutës.*

- *Argumentet e Presidentit në dekretin e tij, janë më së shumti një hartim mbi të drejtat dhe standardet në parim që nuk i përgjigjen situatave konkrete që rregullon ligji 118/2020, megjithatë po i marrim me radhë këto argumente duke dhënë arsyet pse gjykohet që nuk qëndrojnë, si vijon :*

***1. Argumenti i Presidentit : Ligji nr.118/2020, përkeqëson pozitën e partive të vogla dhe shkakton diskriminim. Ndryshimi i pragut elektoral dhe zhbancimi i konvertimit të votave në mandate përfaqësuese në Kuvend***

***Kundërshtimi:***

Vlen të theksohet paraprakisht se Kodi Zgjedhor në fuqi dhe dispozitat e Kodit Zgjedhor të kontestuara nga Presidenti nuk kanë ndryshim në lidhje me ekzistencën e një pragu zgjedhor si një kusht për të përfituar mandate përfaqësimi. Propozimi i ri i referohet vetëm shkallës së këtij pragu, duke kaluar nga rajonal në kombëtar dhe kjo në një reflektim taksativ të parashikimit kushtetues. Çdo argument apo kontestim në lidhje me këtë aspekt është i palegjitimuar për sa kohë që Presidenti nuk mund të shprehet mbi ndryshimet kushtetuese, si një prerogativë e vetme e ligjvënësit. Çfarë propozohet në parashikimin e ri të Kodit Zgjedhor, si delegim nga Kushtetuta, është vlera e pragut kombëtar zgjedhor si një nevojë për të ngritur përfaqësimin e subjekteve zgjedhore përfaqësuese në parlament të interesave jo vetëm rajonale, por edhe ato kombëtare. Sa më sipër ndryshon perspektivën e argumenteve të Presidentit, pasi nuk jemi në kushtet e parashikimit të një barriere të re për subjektet zgjedhore e për këtë nuk ka nevojë të arsyetohej nëse pragu kombëtar lehtësonte apo rëndonte pozitën e subjekteve zgjedhore. Në çdo rast dhe me qëllim dhënien e një përgjigjeje mbi këtë argument të Dekretit të Presidentit, pavarësisht mungesës së koherencës së tij, më poshtë arsyetimi i kontestimit të argumentave të Presidentit.

Pragu kombëtar është në përputhje me standardet e mira në zgjedhje dhe nuk shkakton diskriminim. Kushtetuta e parashikon pragun kombëtar në nenin 64 të saj. Nivelin e pragut Kushtetuta ia lë si detyrë ligjvënësit ta përcaktojë në ligjin zgjedhor.

Siç e kanë arsyetuar anëtarët e Komisionit gjatë shqyrtimit të ndryshimeve kushtetuese të 30 korrikut, bazuar në opinionet e ekspertëve konstitucionalistë:

Në disa sisteme zgjedhore, pragu përcaktohet me ligj në mënyrë artificiale. Ky njihet si pragu ligjor (artificial ose formal). Partitë që nuk marrin numrin minimal të votave të përcaktuara me ligj, nuk marrin asnjë vend. Shtetet me prag ligjor ndryshojnë sipas përqindjes së zgjedhur. Për shtetet anëtare të Komisionit të Venecias ky diapazon është midis 0.67%, më i ulët (në Holandë) deri në 10%, më i lartë (në Turqi). Kështu, disa ligje parashikojnë që një sasi e caktuar votash duhet të merren në nivelin elektoral rajonal (p.sh. Spanjë apo sistemi aktual shqiptar). Të tjerët kërkojnë prague ligjore në rang kombëtar (p.sh. Gjermania). Sipas Komisionit të Venecias është e pamundur të vlerësohet se cili nga këto sisteme është më shumë/më pak i favorshëm për qasjen e partive dhe cila është shkalla aktuale e gjithëpërfshirjes/ekskluziviteti të përfaqësimit. Për më tepër, ekzistojnë dallime midis vendeve në lidhje me fazën e aplikimit të pragut: nëse pragu ligjor zbatohet në ndarjen e parë, të dytë apo ndonjë raund tjetër pasues të ndarjeve të vendeve.

Në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut konstatoi se pragu i 5% të votave që duhej të arrihej nga një listë e kandidatëve, në mënyrë që të konsideroheshin të zgjedhur dhe të merrnin pjesë në ndarjen e vendeve, ishte në përputhje me nenin 3 të protokollit nr.1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut<sup>1</sup>, me argumentin se inkurajon rrymat e përfaqësimit të mjaftueshëm të mendimit dhe ndihmon për të shmangur një copëzim të tepërt të Parlamentit (*Partia "Jaunie Demokrati" dhe Partia "Mūsu Zeme" kundër Letonisë*).

Në rastin e *Strack dhe Richter kundër Gjermanisë*, Gjykata iu referua praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së për pragjet zgjedhore në dritën e Konventës (33 §). Për më tepër, adresoi çështjen e pragut për herë të parë nën aspektin aktiv të nenit 3 të protokollit nr.1, sepse çështja i ishte referuar asaj nga votuesit. Aplikantët u ankuan për një prag prej 5% të votave të hedhura në nivel kombëtar që një parti politike të ishte në gjendje të kërkonte njërin prej vendeve për Gjermaninë në Parlamentin Evropian. Gjykata e Strasburgut e hodhi poshtë kërkesën, duke gjetur se **ndërhyrja ishte proporcionale me qëllimin e ndjekur (ruajtjen e stabilitetit parlamentar)** në dritën e marzhit të gjerë të vlerësimit që shtetet kanë në çështje të tilla. Gjykata vuri në dukje se Bashkimi Evropian i lejonte shprehimisht shteteve anëtare të rregullojnë pragjet elektorale deri në 5% të votave të hedhura.

Duke marrë parasysh gjetjen e sipërpërmendur, propozimin e një pragu kombëtar në imponim ndaj partive politike, nuk shkelet asnjë ligj apo standard minimal i parashikuar nga instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Mjafton ky rast dhe kjo praktikë e GJEDNJ-së për të hedhur poshtë argumentin e Presidentit se pragu kombëtar shkel nenin 18 të Kushtetutës.

Gjithashtu, duhet të theksohet se pragu elektorale është një element i rëndësishëm në dritën e Kodit të Praktikës së Mirë të Komisionit të Venecias dhe, si i tillë, rekomandohet që të parashikohet në Kushtetutë. Në të vërtetë neni 64 i Kushtetutës përcakton qartësisht se “1. *Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë, të zgjedhur sipas një sistemi zgjedhjesh proporcional me konkurrim rajonal dhe prag kombëtar.*” Pra pragu kombëtar është pjesë e tekstit kushtetues në Republikën e Shqipërisë.

**Kur analizojmë pragu ne i referohemi shpesh efektit juridik të tij: pragu shërben për të garantuar stabilitetin e qeverisjes.** Ajo që harrojmë, pothuajse gjithmonë është diskutimi për racionalin e pragut. Pse ka lindur pragu dhe çfarë përfaqëson ai? Pragu është kushti që kushtetuta (me “kushtetutë” i referohemi të drejtës kushtetuese, tërësisë së normave që rregullojnë fushën, jo kushtetutës si akt), pra, pragu është kushti që kushtetuta u ka vendosur partive politike që ato të mund të ushtrojnë të drejtën “për t’u zgjedhur”. Pragu nuk ka asnjë lidhje me të drejtën e partive politike për të konkurruar, nuk e prek atë. Pragu ka lidhje me të drejtën e tyre për të përfaqësuar. Ky kusht është në vështrim kushtetues i njëjtë me kushtin që Kushtetuta u ka vendosur shtetasve për të ushtruar të drejtën për të zgjedhur, i njëjtë me kushtin e moshës 18 vjeç. Nëse mund ta

---

<sup>1</sup> Neni 3 E drejta për zgjedhje të lira

*Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës.*

shprehim ndryshe: me prapun, Kushtetuta ka thënë: partitë politike që nuk fitojnë një përqindje të votave të vlefshme “nuk kanë mbushur moshën madhore”, prandaj nuk mund të përfaqësojnë.

Nëse pragu duhet të jetë 3 për qind, apo 1 apo 2 për qind apo 5 për qind ky është gjykim i pastër politik nëse do të udhëhiqet **nga interesi për të gjallëruar shpejt dhe masivisht skenën politike, apo nga interesi për të mbajtur konkurrueshmërinë në nivele modeste/ të pranueshme, por serioze etj.**

Dokumentet ndërkombëtare sugjerojnë, sikurse pritet, moderacion në gjykimin për prapun. Pragu nuk duhet të përdoret me qëllim përjashtimin e konkurrentëve seriozë, nuk duhet të synojë eliminimin e konkurrencës reale. E rëndësishme është që dokumentet ndërkombëtare nuk janë kundër praput, por kundër abuzimit me të. **Pragu duhet të vendoset në një nivel të tillë, i cili të mos bëhet dot pengesë për rigjallërimin e partive të vogla, por të jetë nxitës dhe motivues në proceset e tyre politike.** Ai thjesht duhet lënë të prodhojë efektet e pritshme prej tij, dhe pragu 1% e garanton këtë synim. Pragu eliminon krahinizmat dhe e bën deputetin të ketë një mandat sipas nenit 70 të Kushtetutës që shprehimisht thotë:

*“Deputetët përfaqësojnë popullin dhe nuk lidhen me asnjë mandat detyrues....”.*

Në lidhje me argumentet e presidentit ilustruar me numrin e ndryshëm të votave që mund t’u duhet subjekteve politike për të fituar mandat deputeti në një qark, neni përkatës i ligjit që kthehet ka marrë për bazë pikën 2.2. të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias. Edhe në Kodin aktual në fuqi situata paraqitet e njëjtë dhe nuk ka patur kundërshtime nga asnjë subjekt, pasi formula d’Hont që aplikohet në vendin tonë merr për bazë në shpërndarjen e mandateve numrin e zgjedhësve dhe numrin e votuesve për çdo subjekt në çdo zonë zgjedhore. Ky numër varion sipas pjesëmarrjes në votime por formula është e njëjtë dhe nuk krijon peshë të ndryshme votash në qarqe të ndryshme. Ajo që quhet peshë e ndryshme votash ka të bëjë më shumë me shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore dhe ku në rastin e Shqipërisë është edhe numri mesatar për mandat bazuar në popullsinë e çdo zone zgjedhore.

Nëse do të qëndronim në këtë argument të Presidentit në lidhje me pabarazinë e votës në variantin e koalicioneve të përbëra me lista të veçanta, siç është aplikuar deri në zgjedhjet e vitit 2013, devianca është shumë më e theksuar, ku një parti pjestare e një koalicioni mund të përfitonte mandat edhe me 6500 vota teksa një subjekt që garonte më vete mund t’i duheshin mbi 10 mijë vota për një mandat, apo në rastin e Tiranës ky numër mund të jetë edhe 13 mijë vota në varësi të pjesëmarrjes dhe arritjes së praput të mëparshëm 3%.

Gjykata e Strasburgut në vendimet e saj u njeh shteteve një marzh të gjerë vlerësimi në zgjedhjen e sistemit zgjedhor, megjithatë, shtetet kanë detyrë që të zgjedhin ato sisteme të cilat jo vetëm sigurojnë shprehjen e lirë të votuesve, por edhe respektojnë parimin e barazisë së trajtimit të të gjithë qytetarëve, megjithëse jo të gjitha votat duhet domosdoshmërisht të kenë peshë të barabartë sa i përket rezultatit të zgjedhjeve dhe as të gjithë kandidatët nuk kanë domosdoshmërisht shanse të barabarta për fitore.

Në lidhje me pragun elektoral, vendet e BE-së parashikojnë në legjislacionin e tyre prag elektoral. Shqipëria si shtet unitar duhet të ketë një prag elektoral në nivel kombëtar.

Kushtetuta përcakton pragun kombëtar si një element korrigues të sistemit, por nivelin e tij ia ngarkon Kuvendit ta caktojë në Kodin Zgjedhor. Kjo për arsye se vendosja e nivelit të pragut në Kushtetutë nuk lejon mundësinë që me ndryshimin e faktorëve politikë, ekonomikë, demografikë etj. ky prag të mund të ndryshohet.

Pragu nuk ka asnjë lidhje me të drejtën e partive politike për të konkurruar, pra nuk e prek atë. Pragu ka lidhje me të drejtën e subjekteve elektorale që marrin mandate që të mund të përfaqësojnë interesa të votuesve në rang kombëtar.

Vlen të theksohet se sistemi aktual elektoral në fuqi në Shqipëri zbaton aplikimin e një pragu zgjedhor në vlerën 3%. Diferenca me ndryshimet kushtetuese të 30 korrikut, konsiston në natyrën e këtij pragu- nga prag me natyrë rajonale në prag me natyrë kombëtare. Siç e tregon edhe tradita tashmë e zgjedhjeve të viteve të fundit, ekzistenca e pragut elektoral nuk ka penguar partitë politike të garojnë në garën politike. Në fakt ato kanë garuar së bashku me subjekte elektorale që platformave të tyre, shpesh me natyrë rajonale, u janë afruar duke u përfshirë në garë së bashku me këto subjekte. Ndryshimi i natyrës së pragut nga rajonal në kombëtar ndikon ndjeshëm në sjelljen në parlament të atyre platformave politike të cilat pavarësisht numrit të votave që marrin në një rajon të caktuar, duhet të kenë shtrirje në të gjithë territorin. Kjo nxit partitë e vogla të kenë interes dhe të punojnë jo vetëm një një zonë zgjedhore por që të prezantojnë ofertën e tyre politike edhe te votuesit e zonave të tjera zgjedhore.

Qëllimi është rigjallërimi i partive të vogla, nxitja dhe motivimi i tyre për t'u bërë pjesë e proceseve politike, rritja e konkurrencës dhe arritja e qëllimit themelor të procesit zgjedhor, që është pikërisht legjitimimi i vullnetit të zgjedhësve nëpërmjet votës së lirë dhe mosdeformimit të këtij vullneti nga truqet elektorale.

- 2. Argumenti i Presidentit: Mbi cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Ndryshimi i njëanshëm i Kushtetutës dhe më pas edhe i Kodit Zgjedhor, cenon veçanërisht parimin kushtetues të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme të individëve apo subjekteve të cilëve norma u drejtohet.*

#### ***Kundërshtimi:***

Presidenti në këtë argument i ka bërë referim Komisionit të Venecias dhe konkretisht Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, miratuar më 18-19 Tetor 2002, në Kreun II, pika 2/b, mbi “Nivelet normative dhe qëndrueshmërinë e të drejtës zgjedhore”, ku shprehimisht thuhet:

*“b. Elementët themelore të së drejtës zgjedhore, dhe, në veçanti, të sistemit zgjedhor, përbërjes së komisioneve elektorale, dhe hartimit të kufijve të zonave zgjedhore, nuk duhet të ndryshohen më pak se një vit përpara zgjedhjeve, ose duhet të shkruhen në kushtetutë ose në një dokument ligjor të një niveli më të lartë se legjislacioni i zakonshëm.”*

Vetë dokumenti që citon Presidenti, pra paragrafi i këtij Kodi të Komisionit të Venecias, parashikon që ndryshimet e elementëve thelbësore të së drejtës zgjedhore nuk duhen ndryshuar një vit para zgjedhjeve, përveç rastit kur parashikimi bëhet në kushtetutë apo në një ligj që nuk është legjislacioni i zakonshëm. Kodi Zgjedhor që ktheu Presidenti është në fakt një ligj jo i zakonshëm sepse miratimi i tij kërkon shumicë të cilësuar, dhe amendimet e Kodit Zgjedhor burojnë nga Kushtetuta.

Pra, asnjë ndryshim nuk po ndodh me një ligj të thjeshtë, gjë që do vinte në kundërshtim me standardet më të mira, por me një ligj që kërkon për miratim shumicë të cilësuar. Kujtojmë se ndryshimet e Kodit Zgjedhor u miratuan me 97 vota në Kuvend në seancën e datës 5 tetor 2020. Edhe një jurist i vitit të parë të Fakultetit të Drejtësisë mund ta dallojë fare qartë që si Kushtetuta dhe ndryshimet e Kodit Zgjedhor të 5 tetorit vijnë në përputhje të plotë me vetë sa citon Presidenti në argumentet e veta, dhe konkretisht me pikën 2/b të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore.

Për më tepër, si çështjet që parashikohen në Kushtetutë, pjesë e nismës për amendim të Kushtetutës në 30 korrik 2020, ashtu dhe çështjet e Kodit Zgjedhor që detajojnë parashikimet e Kushtetutës që janë aspekte të rëndësishme të sistemit zgjedhor si mekanizma korrigjues, nuk kryejnë ndryshimin e sistemit zgjedhor. Komisioni i Venecias në Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore CDL AD (2002) 023, dhe i lexuar dhe interpretuar nën dritën dhe sqarimin shterues të Deklaratës Interpretuese të Komisionit të Venecias mbi Qëndrueshmërinë e Legjislacionit Zgjedhor CDL AD (2005) 043, përcakton, ndër të tjera, se “sistemi zgjedhor në kuptim të ngushtë” konsiston jo në çdo aspekt apo rregull të tij por vetëm në ato rregulla që transformojnë votat në mandate.

Referuar interpretimit të Komisionit të Venecias në Deklaratën Interpretuese përmendur më sipër, për pikën II.2.B në Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias, shprehimisht përcakton se: “...b. Elementët themelore të së drejtës zgjedhore, në veçanti, lloji i sistemit zgjedhor në kuptimin e ngushtë, përbërja e komisioneve elektorale, dhe hartimi i kufijve të zonave zgjedhore, nuk duhet të ndryshohen më pak se një vit përpara zgjedhjeve, ose duhet të shkruhen në kushtetutë ose në një dokument ligjor të një niveli më të lartë se legjislacioni i zakonshëm”. Po në të njëjtin dokument Komisioni i Venecias sqaron se elementët thelbësore të natyrës së vecantë, në kuptimin e ngushtë të legjislacionit mbi zgjedhjet janë: i) natyra e sistemit zgjedhor; ii) kufijtë e zonave elektorale; iii) përbërja e komisioneve që menaxhojnë zgjedhjet.

Rezulton se amendamentet e Kushtetutës të 30 korrikut dhe amendimet e Kodit Zgjedhor të 5 tetorit, nuk prekën asnjë prej elementëve thelbësore të përmendur më sipër, pasi i) sistemi mbetet

siç është, proporcional rajonal; ii) zonat zgjedhore nuk ndryshojnë në kufijtë e tyre; iii) amendimet e Kushtetutës nuk përmbanin ndryshime në komisionet e zgjedhjeve.

Ndryshimet e 30 korrikut në Kushtetutë, që në hierakinë e akteve ligjore është akti më i lartë në Shqipëri, nuk bënë ndryshim të sistemit zgjedhor në aspektin procedural dhe janë plotësisht në përputhje dhe me standardet që parashikohen në pikën II.2.B të Kodit Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias.

### ***3. Argumenti i Presidentit: Mbi pengimin e koalicioneve parazgjedhore, duke imponuar listën shumemërore të përbashkët dhe deformimi i votës.***

#### ***Kundërshtimi:***

Në lidhje me koalicionet parazgjedhore:

**Koalicionet parazgjedhore:** Kushtetuta parashikon të drejtën e paraqitjes së kandidatëve për deputetë nga subjektet zgjedhore: nga partitë politike dhe nga zgjedhësit (neni 68).

Kushtetuta nuk ndalon paraqitjen e kandidatëve për deputetë nga disa parti politike në një listë. Koalicionet parazgjedhore sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor sot në fuqi reduktojnë konkurrueshmërinë. Në praktikën e proceseve zgjedhore të zhvilluara në vendin tonë, koalicionet parazgjedhore, në zbatim të parashikimeve aktuale në Kodin Zgjedhor, janë përdorur nga partitë e vogla për të anashkaluar pragun ligjor të zgjedhjeve. Nëpërmjet bashkimit me një parti të madhe, partitë që nuk arrijnë pragun elektoral dhe që nuk kanë fuqi të marrin tre për qind të votave të përcaktuar në ligjin elektoral, kthehen në parti parlamentare, jo për vullnet të zgjedhësve, por për shkak të formimit të koalicioneve parazgjedhore me partitë e mëdha. Duke reduktuar konkurrueshmërinë, koalicionet parazgjedhore reduktojnë mundësinë e zgjedhësve për të bërë zgjedhjen sipas vullnetit të tyre, e cila konsiderohet ndërhyrje në të drejtën e tyre për të zgjedhur.

Për subjektet zgjedhore vlen të përmendet se standardi minimal, siç parashikohet në paragrafin 7.5 të dokumentit të Kopenhagen-it të OSBE-së, njeh të drejtën e qytetarëve për të kandiduar si përfaqësues politikë **individualisht** ose si **përfaqësues të partive ose organizatave politike**, pa asnjë diskriminim.

Sidoqoftë, në ushtrimin e të drejtës për të marrë pjesë në zgjedhje dhe të së drejtës për t'u organizuar në shoqata politike, individët nuk duhet të kenë pengesa që të organizohen në partitë politike në liri të plotë, siç parashikohet në paragrafin 7.6 të Dokumentit të Kopenhagen-it. Formulimet e këtyre paragrafëve nuk çojnë në ndonjë të drejtë të partive politike të organizohen në ndonjë koalicion parazgjedhor.

Koalicionet parazgjedhore janë konceptuar dhe krijuar me qëllimin e korrigjimit të efektit të sistemeve zgjedhore se sa në përputhje me ndonjë standard, kështu që as GJEDNJ-ja, as Komisioni i Venecias nuk e kanë vlerësuar, përkatësisht, në ndonjë vendim apo mendim, nëse kufizimi i



koalicioneve parazgjedhore si subjekte për të kandiduar për zgjedhje mund të shkelë të drejtën për t'u zgjedhur.

Standardi minimal për t'u njohur si subjekte elektorale arrihet nëse individët dhe partitë politike (ose organizatat politike) kanë të drejta të tilla të parashikuara në legjislacionin përkatës. Siç tregohet nga përvoja e demokracive të konsoliduara, si Holanda apo Gjermania, pamundësia e koalicionit parazgjedhor në formën që parashikon sot Kodi Zgjedhor në fuqi, që të regjistrohet si subjekt zgjedhor, nuk cenon ndonjë të drejtë ose standard të përmirësuar në instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Gjithashtu, nuk duhet të ngatërrohet liria e organizimit me të drejtën e koalicionit parazgjedhor siç parashikohet sot në Kodin Zgjedhor. Forma e koalicioneve që parashikon Kodi Zgjedhor në fuqi nuk përfaqëson asnjë standard të mirë në zgjedhje dhe nuk gjendet në asnjë nga vendet anëtare të Komisionit të Venecias.

Liria e organizimit, si një liri negative e garantuar nga Kushtetuta, ka për qëllim dhënien e mundësisë shtetasve për t'u grumbulluar dhe organizuar të lirë dhe sipas preferencës, për synime dhe objektiva të përbashkëta, të cilat jo domosdoshmërisht lidhen me ushtrimin e profesionit. Njihen dhe organizime të cilat mbi bazën e tyre kanë mbrojtjen e interesave profesionalë si p.sh sindikatat, ngritja dhe veprimtaria e të cilave është e garantuar nga vetë Kushtetuta në nenin 50 të saj. Në rastin konkret, koalicionet parazgjedhore sipas Kodit në fuqi janë formacione me karakter elektorale dhe të përkohshëm, pa personalitet juridik. Formimi i tyre nuk shkrin as anulon identitetin dhe personalitetin juridik të partive pjesëmarrëse në to. Kjo do të thotë se ato nuk përfshihen dot brenda nocionit kushtetues të nenit 46 (organizata ose shoqata). Formimi i koalicioneve parazgjedhore nuk është as e drejtë, as liri kushtetuese. Në kuptimin ligjor, koalicioni parazgjedhor është mekanizëm apo teknikë elektorale atje ku është i parashikuar nga ligji, sikurse nuk ekziston atje ku nuk është i parashikuar nga ligji.

Referuar parashikimeve kushtetuese në fuqi, të drejtën për të propozuar kandidatë për deputetë e kanë partitë politike ose zgjedhësit (subjekte propozuese). Dispozita kushtetuese mundëson që disa parti politike të propozojnë në një listë të përbashkët kandidatët për deputetë, por subjekt propozues duhet të jetë partia politike dhe jo një grupim partish në formën e koalicioneve siç ndodhte përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, që hynë në fuqi në 08.09.2020. Pra, subjekt propozues për kandidatin për deputet është partia politike, ndërsa grupimi i partive që zgjedhin të konkurojnë bashkë me një listë kandidatësh për deputetë është subjekt zgjedhor që garon nën udhëheqjen e partisë që drejton këtë grupim, të cilit i referohemi si koalicion zgjedhor. Koalicioni zgjedhor parashikohet si subjekt zgjedhor që konkuron në zgjedhje në ligjin e kthyer nga Presidenti.

Kundërshtimi i Presidentit qëndron në faktin pse forma e këtij koalicioni që propozohet me listë të përbashkët nuk është njësoj si më parë, kur votat e subjekteve të koalicionit që nuk bënin dot një mandat të mos i marrë një parti tjetër brenda koalicionit që garonte me lista të përbëra.

E kemi sqaruar disa herë gjatë mbledhjeve të Komisionit për Çështjet Ligjore, por dhe ekspertët konstitucionalistë gjatë shqyrtimit të amendamenteve kushtetuese të 30 korrikut kanë sqaruar me profesionalizëm e bazuar në standarde ndërkombëtare se 1- koalicionet me listë të përbërë deformojnë vullnetin e votuesit (boll fakti që votat e subjekteve të koalicionit që nuk bënin dot një mandat i merr një parti tjetër brenda koalicionit me lista të përbëra, kuptohet që vullneti i votuesit për t'i dhënë besim partisë A brenda koalicionit i shkon partisë B, tregon për pabarazinë e votës dhe deformimin e vullnetit të zgjedhësit); 2 –Forma e koalicioneve që parashikon Kodi Zgjedhor në fuqi nuk përfaqëson asnjë standard të mirë në zgjedhje dhe nuk gjendet në asnjë nga vendet anëtare të Komisionit të Venecias; 3 – sistemi me lista të hapura nuk shkon me koalicionet që preferon Presidenti.

Argumentet e Presidentit kanë shumë emocion brenda dhe perceptim politik. Në fakt duhet të kishte ardhur dita që Shqipëria të ishte shkëputur nga kjo mënyrë gjykimi si e Presidentit që ka përmendur më shumë partitë opozitare në argumente sesa zgjedhësit.

Për t'u kthyer tek analiza, koalicioni parazgjedhor që ne kemi në fuqi është adoptuar në praktikën politike për dy shkaqe themelore:

**Së pari**, partitë e vogla e duan koalicionin parazgjedhor për të anashkaluar pragun ligjor të zgjedhjes. Për të anashkaluar një kusht të vendosur nga ligji kushtetues!!!! Nëpërmjet bashkimit me një parti të madhe, partitë që nuk kanë fuqi të marrin 3 për qind të votave dhe që ligji, për këtë shkak nuk i njih për “madhore” bëhen “madhore”, jo për vullnet të zgjedhësve, por në sajë të një truku ligjor.

**Së dyti**, partitë e mëdha e duan koalicionin parazgjedhor për të reduktuar konkurrueshmërinë në zgjedhje, sidomos në pjesën e tyre të spektrit politik. Reduktimi i konkurrueshmërisë do të thotë reduktim i mundësive të zgjedhësit për të bërë zgjedhjen që do, do të thotë ndërhyrje (nuk është ende cenim, por është vetëm ndërhyrje) në të drejtën e tij për të zgjedhur. Fakti që koalicioni është me listë të përbërë dhe partitë e koalicionit votohen gjithësesi, nuk e zhbën këtë synim, sepse ai heq garën midis tyre, neutralizon fushatën për vete dhe kundër njëri-tjetrit, sikundër dobëson gradualisht aftësitë dhe kapacitetet politike të partive të vogla, deri në pikën e shpërbërjes së alternativës që ato përfaqësojnë. Deri në këtë pikë, të dy këto synime nuk janë koherente me Kushtetutën. Ato janë të ligjshme, por nuk janë koherente. Çështja bëhet më problematike po të analizojmë efektin që koalicioni parazgjedhor ka mbi të drejtën për të zgjedhur, sepse këtu vjen përplasja reale me Kushtetutën. Koalicioni me listë të përbërë, për shkak të formulës së adoptuar në Shqipëri lidhur me shpërndarjen e mandateve brenda koalicionit, shkakton në çdo palë zgjedhje transferim të votës nga një parti tek një tjetër. Sasia e votave që transferohen është e matshme deri në çdo votë. Nganjëherë ajo është disa mijëra, nganjëherë disa qindra, por nuk është asnjëherë irrelevante, sepse transferimi i votës prodhon mandate deputetësh. Ky transferim votash është

modifikim i vullnetit të zgjedhësve, është tjetërsim i votës. Modifikimi i vullnetit të zgjedhësve dhe tjetërsimi i votës përbëjnë cenim të të drejtës themelore kushtetuese të zgjedhjes.

Ligji nr.118/2020 garanton garën e ndershme zgjedhore. Formula e ndarjes së mandateve brenda partive të koalicionit zgjedhor, sipas marrëveshjes së koalicionit, përcaktohet në bazë të votave që merr çdo kandidat i listës së koalicionit dhe formulës së përcaktuar në ligj si për të gjithë kandidatët e tjerë të partive që garojnë më vete. Ky është modeli që kanë të gjitha vendet evropiane që kanë sistem proporcional rajonal me votë preferenciale.

Ligji nr.118/2020, që ka kthyer Presidenti, mban në konsideratë përveç të tjerave, jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Deklaratën e Kopenhagenit të OSBE-së, Kodin e Praktikës së Mirë për Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias, Deklaratën Interpretuese të Komisionit të Venecias mbi Qëndrueshmërinë e Legjislacionit Zgjedhor dhe Udhëzuesit për Hartimin e Legjislacionit Zgjedhor të OSBE-ODIHR si dhe modele të ngjashme me sistemin zgjedhor në Shqipëri ku përmendim Austrinë, Kroacinë, Republikën Çeke, Suedinë, Danimarkën. Grupi i punës mbajti në konsideratë dhe kërkesat e subjekteve politike parlamentare dhe joparlamentare të paraqitura zyrtarisht ose të artikuluar në publik, duke i adresuar ato në frymën e parashikimeve kushtetuese, (psh. përfaqësuesi i opozitës parlamentare në Këshillin Politik, në mbledhjet e qershorit 2020 ka propozuar që Shqipëria të aplikonte sistemin danez që parashikon një formulë të ngjashme me atë që parashikon ligji 118/2020 sa i takon ndryshimit të renditjes në listë nëpërmjet asaj që quhet “Droop Quota”).

Pretendimet e Presidentit se i) Kjo zgjedhje, duket se është bërë për të shkaktuar kundërvënie mes partive opozitare që duan të bëjnë koalicion parazgjedhor, ii) Ky lloj kufizimi, përkthehet në pakësim të mundësive që qytetarët të zgjedhin atë program politik të ofruar që mund të realizohet më mirë dhe më shpejt nën një frymë bashkëpunimi mes partive; iii) parashikimi i bërë në nenin 11 të ligjit nr. 118/2020, është imponues; iv) rregullat për vlefshmërinë e fletës së votimit kur nuk votohet subjekti po veç individit krijojnë diskriminim etj, janë argumente që nuk kanë asnjë bazueshmëri në ndonjë ligj apo standard dhe mungon arsytimi në Dekret për këto pretendime, ndaj i konsiderojmë të pabazuara.

Në lidhje me pretendimin se kryetari i partisë ka të drejtë të garojë në më shumë se një qark, sqarojmë se:

Sipas Nenit 68 të Kushtetutës: ‘*Kandidatët për deputetë paraqiten në nivel zone zgjedhore nga partitë politike ose nga zgjedhësit. Një kandidat mund të paraqitet vetëm për një nga subjektet propozuese, sipas kësaj pike. Rregullat për regjistrimin e kandidatëve për deputetë përcaktohen në ligjin për zgjedhjet*’.

Nga parashikimi më lart del se Kushtetuta përcakton që një kandidat të paraqitet vetëm për një nga subjektet propozuese, por nuk pengon që kandidati për deputet të jetë i regjistruar në listën emërore të më shumë se një zone zgjedhore.

Një rregull i tillë është vendosur në Kodin Zgjedhor pasi u krijon shanset optimale partive të reja apo atyre ekzistuese dhe drejtuesve të tyre të përfaqësohen në Kuvend nëse kanë një mbështetje të konsiderueshme elektorale.

**4. Argumenti i Presidentit: Ndryshimet e bëra përmes nenit 8 të ligjit nr. 118/2020, që ndryshon nenin 68 të Kodit Zgjedhor, janë parashikime që favorizojnë deputetë aktualë ilegjitimë, për votën e tyre të dhënë në 5 tetor për forcimin e pozitës së mazhorancës aktuale, dhe krijojnë vështirësi të panevojshme për partitë e tjera politike.**

**Kundërshtimi:**

Sipas Presidentit me këtë ndryshim, është e qartë që jo vetëm favorizohen deputetët e “opozitës” që kanë marrë mandatet pa ndjekur procedurat përkatëse kushtetuese dhe ligjore pas dorëheqjes në bllok nga mandatet të deputetëve të opozitës, por një parashikim i tillë përbën një pengesë serioze jo vetëm për partitë opozitare që ndodhen jashtë parlamentit, që përbëjnë opozitën e vërtetë, por edhe për forcat e reja politike që dëshirojnë të hyjnë në jetën politike të vendit.

Lidhur me çështjen e zëvendësimit të mandateve debati tashmë është ezauruar. Heqja dorë nga mandati është një veprim kushtetues, parashikuar në nenin 71, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës, që bazohet në shprehjen e vullnetit individual. Lënia e mandateve nga 58 deputetët e opozitës parlamentare është bërë me vullnetin e tyre të lirë dhe zëvendësimi i tyre nga kandidatët e tjerë të listave është kryer nga Kuvendi i Shqipërisë, bazuar në procedurat e parashikuara në Kushtetutë, në Kodin Zgjedhor si dhe në Rregulloren e Kuvendit.

Kuvendi ka respektuar me rigorozitet parashikimet e nenit 71, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës, në të cilën është parashikuar heqja dorë nga mandati. Ndërsa neni 13 i Rregullores së Kuvendit parashikon në pikën 4 kompetencat e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, i cili shqyrton shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me mandatin e deputetit dhe paraqet raportin përkatës në seancë plenare. Ligjvënësi me këtë formulim ka pasur parasysh çështjet e parashikuara në nenin 69 dhe 70 të Kushtetutës për rastet e pazgjedhshmërisë dhe papajtueshmërisë së ushtrimit të funksionit të deputetit si dhe çështje të konfliktit të interesit.

Në nenin 164 të Kodit Zgjedhor parashikohet se “*Në rastin e shkronjave “a” dhe “b” të pikës 2 të nenit 71 të Kushtetutës, deputeti deklaron në mënyrë publike përpara komisionit përkatës të Kuvendit refuzimin për të bërë betimin ose heqjen dorë nga mandati. Në këtë rast Kuvendi, jo më vonë se 30 ditë, njofton KQZ-në për krijimin e vakancës.*”

Bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese (Vendimi nr. 6, datë 18.1.2002 ) me fjalën “shqyrtim” kuptohet e drejta dhe detyrimi i Kuvendit për të bërë objekt diskutimi e debati një çështje të caktuar dhe për të marrë një vendim të caktuar për miratimin ose mosmiratimin e çështjes në fjalë. Termi shqyrtim kërkon detyrimisht vendimmarrje nga Kuvendi.

Në rastin e heqjes dorë nga mandati të deputetit nuk ka vendimmarrje, pasi dorëheqja është një akt individual, dhe heqja dorë nga mandati nuk përbën një “çështje”, por një veprim individual me vullnet të plotë, rrjedhimisht nuk ka nevojë për procedurë të posaçme për të detajuar veprimin e heqjes dorë, sipas nenit 71, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës.

Ndërsa në lidhje me përcaktimin në dispozitat e mësipërme që deputetët heqin dorë në mënyrë individuale, dhe jo në bllok siç pretendon presidenti, akti zyrtar, i cili prodhon efektet juridike të aktit individual, është deklarimi me shkrim i deputetit për heqjen dorë nga mandati që depozitohet në Kuvend, dhe në protokollin e Kuvendit janë të depozituara dorëheqjet individuale për çdo deputet të opozitës.

***5. Argumenti i Presidentit: Trajtimi i pabarabartë në mënyrën e deklarimit të trajtimit të dhurimeve, huave dhe kredive, si një pengesë më shumë për koalicionet parazgjedhore.***

***Kundërshtimi:***

Presidenti parashtroi se neni 90 i Kodit Zgjedhor, ishte një ndër nenet që u ndryshua si pasojë e kodifikimit të Marrëveshjes së 5 qershorit dhe u miratua përmbajtja e kësaj dakordësie me ligjin nr. 101/2020 të datës 23 korrik 2020. Ky nen përcaktoi qartë mënyrën e trajtimit të dhuratave, huave dhe kredive. Konkretisht, në pikën 2 të nenit 90, u përcaktua se:

*“2. Për qëllime të zbatimit të këtij ligji, dhurimet në vlera monetare, në natyrë apo në formën e shërbimit që u jepen kandidatëve të subjekteve zgjedhore, si dhe huatë ose kreditë e marra nga kandidatët për financimin e fushatës konsiderohen si kontribute për partinë politike për të cilën ata kandidojnë. Për kandidatët e propozuar nga koalicionet, partitë politike pjesëmarrëse në koalicion përcaktojnë në marrëveshjen për krijimin e koalicionit se cila parti do të deklarojë të ardhurat dhe shpenzimet e kandidatit.”*

Sipas Presidentit, tashmë bëhet një ndryshim tepër i paqartë në këtë dispozitë, përmes nenit 10 të ligjit nr. 118/2020, duke shfuqizuar fjalinë e dytë të pikës 2, të nenit 90. Kjo fjali që synohet të shfuqizohet, parashikonte se:

*“Për kandidatët e propozuar nga koalicionet, partitë politike pjesëmarrëse në koalicion përcaktojnë në marrëveshjen për krijimin e koalicionit se cila parti do të deklarojë të ardhurat dhe shpenzimet e kandidatit.”*

Presidenti pretendon se me shfuqizimin e këtij parashikimi, synohet të krijohet edhe një pengesë më shumë për krijimin e koalicioneve parazgjedhore, përmes nxitjes së mosmarrëveshjeve mes partive edhe për çështjet e koordinimit të informacionit nga kandidatët dhe ekspozimit të tyre ndaj penalteteve, për shkak të raportimeve të kandidatit të propozuar nga një prej partive pjesë e koalicionit.

Në kundërshtim të këtij argumenti, sqarojmë se në këtë parashtrim të Presidentit mungon logjika e shëndoshë, për arsyen e thjeshtë se adresimi i parashikimeve kushtetuese në Kodin Zgjedhor, lidhur me koalicionin zgjedhor me listë të përbashkët, ka mbajtur në konsideratë gjithë elementët që koalicioni si subjekt garues duhet të përmbushë dhe kjo është praktikë apo standard që aplikohet në disa vende anëtare të BE apo Komisionit të Venecias, (shih rastin e Hollandës apo Kroacisë).

***6. Argumenti i Presidentit - Synimi për të ndikuar në pavarësinë dhe paanësinë e Kolegjit Zgjedhor, për kapjen politike të tij nëpërmjet shfuqizimit të togfjalëshit ‘ngritje në detyrë’ në nenin 149 të Kodit Zgjedhor***

***Kundërshtimet:***

Me shfuqizimin e pengesës së magistratëve që shërbejnë në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor për t’u ngritur në detyrë është garantuar e drejta e tyre kushtetuese dhe e parashikuar në ligjet e reformës në drejtësi për të bërë karrierë në sistemin gjyqësor, të drejta të mbrojtura dhe ndërkombëtarisht.

Shfuqizimi i bërë në nenin 149 të Kodit Zgjedhor nuk cenon paanshmërinë e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor dhe as krijon kushte për kapjen politike të anëtarëve të Kolegjit, pasi tashmë me zbatimin e reformës në drejtësi kompetent për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, përfshirë dhe ata të Kolegjit Zgjedhor, nuk është as Kuvendi, as Presidenti dhe asnjë organ tjetër ekzekutiv, por organi i pavarur, Këshilli i Lartë Gjyqësor, që funksionon dhe organizohet si një organ kushtetues i pavarur në përbërje të të cilit ka anëtarë magistratë, që zgjidhen prej gjyqtarëve, dhe anëtarë jomagjistratë, që zgjidhen nga Kuvendi pas një procesi verifikimi nga Avokati i Popullit, universitetet, dhomat e profesioneve të lira si avokatia etj. dhe nën mbikqyrjen e Misionit Ndërkombëtar të Monitorimit që ushtron veprimtari në Shqipëri.

Në këto kushte, nuk ka pse të frikësohet askush që beson te reforma në drejtësi dhe zbatimi i saj. Për më tepër, në kuadër të thirrjeve publike të Presidentit për plotësimin sa më parë të vakancave në Gjykatën e Lartë, ky ndryshim në nenin 149 duhej të ishte vlerësuar dhe përshëndetur nga Presidenti.

***7. Argumenti i Presidentit - Ndryshimet në Kodin Zgjedhor përmes ligjit nr.118/2020, nuk realizojnë zhvillimin e një procesi zgjedhor përmes listave tërësisht të hapura siç u premtua***

***Kundërshtimet:***

Lista e kandidatëve të partisë politike/koalicionit zgjedhor do të jetë 100% e hapur. Të gjithë kandidatët në listë i nënshtrohen votimit parapëlqyes nga zgjedhësit. Çdo zgjedhës ka të drejtën që krahas partisë apo koalicionit zgjedhor të vendosë shenjën edhe tek emri i një

kandidati/kandidateje të preferuar. U jepet e drejta zgjedhësve që të ndryshojnë renditjen e kandidatëve dhe respektivisht ndarjen e mandateve duke vlerësuar ata kandidatë që demonstrojnë që gëzojnë një mbështetje të madhe, edhe mbi vetë renditjen e partisë që i propozon. Një parim i tillë aplikohet në një sërë vendesh me sistem të ngjashëm elektoral ku zgjedhësit kanë të drejtë të ri-rendisin kandidatët e, rrjedhimisht, edhe mandatet e fituara elektorale. Në vëmendje mund të sjellim shembujt e Austrisë, Kroacisë, Republikës Çeke, Suedisë.

Gjinia më pak e përfaqësuar garantohej se do të jetë jo më pak se 30% e përbërjes së Kuvendit, edhe në kushtet e zbatimit të listave të hapura plotësisht. Një në tre emra të njëpasnjëshëm i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar, si në listën paraprake të depozituar nga subjekti zgjedhor ashtu edhe në listën përfundimtare të mandateve të fituara nga subjekti zgjedhor.

Në lidhje me ndikimin e zgjedhësve në përzgjedhjen e kandidatëve, sistemet proporcionale ndahen në ato me lista të hapura dhe lista të mbyllura.

Në sistemet me lista të hapura, votuesit votojnë për një kandidat individual sipas votës parapëlqyese. Në të tjerat, votuesit mund të zgjedhin midis votimit për një parti dhe/ose zgjedhjes së kandidatit të tyre. Votat për një kandidat e bëjnë atë kandidat me shumë gjasa të jetë në grupin e deputetëve të partisë që zgjidhen. Një votë për një kandidat llogaritet si votë për partinë e tij kur vendoset sa vende duhet të marrë secila parti.

Nën përfaqësimin proporcional të listës së hapur, votuesit votojnë si për një parti ashtu edhe për një ose disa kandidatë brenda listës së saj (vota preferenciale).

Sisteme të ndryshme u japin votuesve peshë të ndryshme ndikimi. Vendet u caktohen partive në proporcion me votat e tyre dhe, brenda partive, për kandidatët që marrin numrin më të madh të votave preferenciale.

Në shumë vende si Holanda, Bullgaria, Kroacia, Austria, Slovakia Suedia etj., ku llogariten votat individuale brenda një liste, një kandidat duhet të kalojë një prag parapëlqyes të përqindjes së votave për të pasur një vend preferencial në listë. Ky lloj pragu garanton që mandatet përfitohen nga kandidatë që demonstrojnë një peshë elektorale që del mbi peshën e ekipit përfaqësues që ka paraqitur subjekti zgjedhor.

Bazuar në këta shembuj, ndryshimet e miratuara me ligjin n.118/2020 garantojnë zbatimin e parimit kushtetues, duke i krijuar mundësinë çdo zgjedhësi të shprehet me votë preferenciale për 3/3 e listës ose thënë ndryshe 100% të saj. Të gjithë kandidatët në listën e partisë politike/koalicionit zgjedhor i nënshtrohen votimit parapëlqyes nga zgjedhësit. Çdo zgjedhës ka të drejtën që krahas partisë apo koalicionit zgjedhor të vendosë shenjën edhe tek emri i një kandidati/kandidateje të preferuar. U jepet e drejta zgjedhësve që të ndryshojnë renditjen e kandidatëve dhe respektivisht ndarjen e mandateve duke vlerësuar ata kandidatë që gëzojnë një mbështetje të madhe, edhe mbi vetë renditjen e partisë që i propozon.

Pragu parapëlqyes i përqindjes së votave fuqizon zgjedhësit, pasi janë votat preferenciale të tyre ato që krijojnë mundësinë e kandidatit për ta fituar mandatin e deputetit, pavarësisht nga pozicioni i zënë në rreshtimin fillestar nga subjekti zgjedhor, tregues ky që lista është praktikisht 100% e hapur.

Gjatë studimit të vitit 2015 të Komisionit të Venecias, midis 31 vendeve që përdorin një sistem të listave të hapura ekzistojnë dallime të konsiderueshme. 7 vende përdorin një sistem me preferencë, ndërsa 24 vende përdorin një sistem me disa preferenca, qoftë me një numër fiks ose me një variabël preferencash.

Sistemet zgjedhore janë të ndryshme dhe mekanizmat korrigjues të sistemeve që aplikohen rast pas rasti bëjnë që të jetë një numër i madh i sistemeve që mund të aplikohen. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se cilido sistem zgjedhor që aplikohet, duhet të respektojë parimet themelore të përmendura në instrumentet ndërkombëtare.

Siç përcaktohet në Kodin e Praktikës së Mirë për Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias, "*çdo sistem zgjedhor mund të zgjidhet*", në respekt të parimeve të përcaktuara në Kod. Kjo u konfirmua në mendimet e fundit të Komisionit të Venecias për vendet specifike, dhe gjithashtu specifikohet në dokumentet e kohëve të fundit se "*Komisioni i Venecias dhe OSBE/ODIHR-i nuk rekomandojnë ndonjë sistem të veçantë zgjedhor. Në mënyrë të ngjashme, nuk ka standarde ndërkombëtare që rekomandojnë një metodë specifike ose shkallë të proporcionalitetit në lidhje me shpërndarjen e vendeve. Shtetet gëzojnë një marzh të gjerë vlerësimi pasi këto zgjedhje janë vendime politike.*"

**8. *Mbi argumentet e mungesës së konsensusit të gjerë politik dhe pretendimet e Presidentit për shkëlqje të marrëveshjes së 5 qershorit, që nuk përbëjnë në fakt lëndë për shqyrtim nga ky komision, por për efekt të transparencës duhet ta trajtojmë.***

Gjykojmë se pretendimet e Presidentit dukshëm janë të njëjta me ato të Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim, të diskutuara gjerë e gjatë në Mbledhjet e Këshillit Politik.

Gjatë debatit të fund të korrikut për amendamentet kushtetuese, qëndrimi zyrtar i PD dhe LSI ka qenë se amendamentet kushtetuese ndalonin koalicionet, se ky ndalim vinte në kundërshtim flagrant me marrëveshjen e 5 qershorit dhe prandaj amendamentet kushtetuese nuk duhet të miratoheshin në atë kohë. Më pas e pranuan zyrtarisht se amendamentet kushtetuese nuk i ndalonin koalicionet, ndërkohë që u pranua nga të gjithë ekspertët në Këshillin Politik se amendimet kushtetuese të 30 Korrikut e për rrjedhojë dhe amendimet e Kodit Zgjedhor me ligjin nr.118/2020 nuk vijnë në kundërshtim me marrëveshjen politike të 5 qershorit 2020.



Përfshirja në Këshillin Politik dhe në proces e mundësoi opozitën jashtë Kuvendit të luante rolin e vet konstruktiv, mundësi që për fat të keq opozita nuk e vlerësoi dhe as e përdori në të mirë të interesit publik. Vlen të theksohet se puna për reformën zgjedhore ka nisur që në tetor të vitit 2017 dhe është humbur jashtëzakonisht shumë kohë për hir të konsensusit të gjerë në realizimin e kësaj detyre, ndaj çdo vonesë tjetër është e pajustificuar.

Kuvendi ka kryer me korrektësi detyrën e vet dhe ka miratuar ndryshimet në Kodin Zgjedhor që adresojnë amendamentet kushtetuese të 30 korrikut në frymë dhe në gërmë.

## **II.PËRFUNDIM**

Në përfundim të pyetjeve dhe diskutimeve, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm vendosi rrezimin e Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11797, datë 22.10.2020, “Për kthimin e ligjit nr. 118/2020 ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, ‘Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë’” i ndryshuar, dhe ia përcjell raportin për votim seancës plenare.

**RELATOR**

**ADNOR SHAMETI**

**KRYETARI**

**ULSI MANJA**